



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Valmirë Deliu	23.09.2024	13.10.2024	2024/0846
Eksperti Teknik	Data e autorizimit të ekspertit teknik		
Mentor Gallapeni	01.10.2024		

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 13.09.2024, OE “GËRLICA - COMPANY SH. P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0846, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “**Ndertimi i unazes se madhe Petrove - Reqak - Belince, Shtime**” me nr. të prokurimit: “**617-24-960-5-1-1**”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA SHTIME.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar: **procedurën e hapur**, lloji i kontratës: **shërbim**, vlera e parashikuar e kontratës: **2,500,000.00€**.

Shënim: *Ju njoftoj se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, nuk është nxjerrë ndonjë vendim nga OSHP-ja.*

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura të LPP-së:

Neni 1 - Qëllimi

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe efikasiteti

Neni 7 - Barazia në trajtim / jo diskriminimi

Neni 69 - Aftësia teknike dhe / ose profesionale

Neni 4 - i Rregullores së Prokurimit nr. 01.2022 dhe

Neni 17.17 i Rregullores së Prokurimit nr. 01.2022

Neni 108A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjes

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Komuna Shtime e ka shpallur aktivitetin “Ndërtimi i unazës së madhe Petrovë - Reçak - Belincë, Shtime” me nr.prok. 617-24-960-5-1-1

Kemi bere kerkese per rishqyrtim ne AK, lidhur me kritere diskriminuese por Ak nuk ka bere asnje ndryshim te kritereve duke I lene ne fuqi kriteret diskriminuese qe ia kemi paraqitur si ne kerkesen per rishqyrtim.

Te bashkangjitur gjeni pretendimet tona ankimore si ne kerkesen per rishqyrtim bazuar ne nenin 108A te LPP-se.

Ne kriteret e vendosura ne njoftim per kontrate dhe ne dosje te tenderit shihet se ka kritere diskriminuese per shume OE dhe favorizuese per nje OE qe bie ne kundërshtim me dipozitat e LPP-se.

Ne piken 9.1 & 9.2 te FDT-se te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, AK ka kerkuar kriteret

Kërkesa 4. Stafi i të punësuarve, minimum 20 puntorë. Menaxheri i projektit të jetë inxh. Idiplomuar i ndertimtarisë- drejtimi konstruktiv(ose master) me minimum, 3 vite pervojë, të jetë I certifikuar per menaxhimte kantierit te ndertimit; një (1) inxh.dipl.hidroteknik (ose master); me minimum, 3 vite pervojë, te jete I certifikuar per Lead Auditor per menaxhimte cilesise ISO 9001 2015; nje (1) inxh.dipl. igjeodezisë (ose master) I licensuar nga AKK; NJË (1) bachelor të gjeodezisë të licensuar nga AKK. me minimum, 3 vite pervojë. Një bsc I ndertimtaris Konstruktiv ,Njebse ne inxhinier i ndertimor edhe infrastructure 3 vite pervoj.Një Master ose Msc.i komunikacionit me se paku 3 vite pervojë pune në realizimin e projekte vetë ngjashme; nje inxhinier ose master i Elektroteknikes me se paku 3 vitepervoje pune ne realizimin e projekteve te ngjashme.Punëtor për siguri dhe mbrojtje në punë 5, dhe 5 punëtoore për mbrojtje nga zjarri të kenë dëshmi certifikatën.

Dëshmia 4. Lista e stafit e të punësuarve, min. 20 punëtor të në nshkruar nga kompania, bashkangjitur kontratat ose parakontratat. Kompania duhet të sjellë listën se paku 20 puntorve te nënshkrur dhe vulosur. Menaxheri i projektit të jetë inxh. iNdertimtarisë–konstruktiv. Diplomat Universitare, të noterizuar nga vet mbajtesit e tyre sidhe pas dates se publikimit te ketij tender për të gjithë inxhinieret si dhe prej datës se Diplomimit 3 vite përvoje, CV dhe Referenca pune, Vendimi per caktimin e Menaxheri te leshuar nga OE. Për punëtor certifikatat e trajnimit kopje të noterizuara nga vetem bajtesit e tyre pas dates se publikimit te ketij tenderi.

Te kriteri i kerkuar si me lart AK ne kete kriter ka kerkuar qe Ing.i diplomuar i ndertimtarise – drejtimi konstruktiv (ose master) me minimum 3 vite pervoje, te jete i certifikuar per menaxhimin e kantierit.

ing. ndertimtarisë – hidro ose MSc të jete të certifikuar si Lead Auditor për menaxhim të cilësive ISO 9001:2015. Pra ky kriter është diskriminues dhe kërkojmë që të hiqen Certifikata e kërkuar Lead Auditor për menaxhim të cilësive ISO 9001:2015, pasi që është e panevojshme dhe si e tillë duhet të hiqet sepse me këto kërkesa po bëni shkeljen e nenit 7 të LPP-se.

Të hiqen këto kritere për stafin pasi që janë të panevojshme dhe kjo ndikon në kufizimin e konkurrencës në kundërshtim me nenin 7 të LPP-se dhe demtimin e buxhetit publik sipas nenit 1 dhe 6 të LPP-se.

Kërkesa 6. Pajisjet Teknike
 1. Eskavator me kapacitet min 35t min 1 cope
 2. Eskavator me kapacitet min 25t min 3 cope
 3. Eskavator me luge rrafshuese levizese ne te dyja anet special per hapjen e kanaleve me kapacitet 1m3 min 26t
 4. Eskavator me çekan 8-10t min 1 cope
 5. Eskavator me zingjirgome min 8t
 6. Buldozer me kapacitet min 15 t min 1 cope
 7. Skip ngarkues min 1 cope
 8. Cilinder min 17t min 2 cope
 9. Cilinder min 12t min 1 cope
 10. Cilinder me dhembeza min 12t min 1 cope
 11. Frezhidraulike qe vendoset ne eskavator per grryerjen e gurit min 2 cope
 12. Ngarkues min 17t min 1 cope
 13. Kamion kipper me kapacitet min 10m3 min 10 cope
 14. Kamion Kiper me

Deshmia 6. Lista e mjeteve të punës (enenshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik për mjetet që nuk regjistrohen nga pika (1 der 12) të deshmohen me fatura të blerjes, kontratat e blerjes ose deklarata unike doganore, për automjetet që regjistrohen nga pika (13 deri 26) librezat e qarkullimit me validitet. Në rast se OE nuk posedon pajisje mbi pronësinë duhet të ofrojë marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohezgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe e vulosur nga të dyjat palet dhe e noterizuar.

kapacitet min 11t me kran me gjatësi min 20m
 15. Eskavator min 10t min 1 cope
 16. Eskavatori me gome max 6t
 17. Gjysem rimorkio kipper me peshebartese min 7t min 1 cope
 18. Gjysemrimorkiokompresor për thyerjetepjeseteforta min 1.5t min 1 cope
 19. Gjysemrimorikosinjalizuese me gjenerator max 1t me kapacitet 12m lartsiore 600m2 ndriqim min 2cope
 20. Rrafshues (greder) min 20 t (me raperadhe laser digjital për nivelizim) min 1 cope
 21. Rrafshues (greder) min 15t min 1 cope
 22. Automikservetengarkues për prodhimin e betonit min 1 cope
 23. Kamionet kipper me peshebartesederi 1 ton min 2 cope
 24. Kamioneta për puntore min 4 cope
 25. Pickup për puntore min 2 cope
 26. Cisterne (tanket) e ujit min 1 cope

Poashtu edhe të makinëria e kërkuar kërkojmë që të hiqen disa kritere që nuk nderlidhen me natyrën e projektit:

3. Eskavator me luge rrafshuese levizese ne te dyja anet special per hapjen e kanaleve me kapacitet 1m3 min 26t

kjo pajisje është diskriminuese sepse asnjë OE nuk mund ta deshmojë me ndonjë dokument kapacitetin m³ kubikazhen, e luges pasi në Kosovë nuk ka institucion apo qendër të licencuar për matje të një gjëje të tillë po ashtu edhe kufizimi tonazhes 26 ton kërkojmë që të jete dhe më i vogël sepse kjo punë mund të kryhet edhe me eskavator psh 22=24 ton etj.

11. Freze hidraulike që vendoset në eskavator për grryerjen e gurit min 2 copë

duke u bazuar në parametere nuk ka kategori të gurit për tu frezuar me frez hidraulike një gjëje të tillë nuk është parapare fare, po ashtu vetëm nga ju në këtë pozicion e keni çekur se do të bëhet thyerja me eskavator me cekun pikërisht që e keni përshkruar në parametere e keni kërkuar që me eskavator të bëhet thyerja dhe për këtë pozicion në kritere e keni kërkuar eskavatorin 8=10 ton me cekun për të cilën mendojmë se është në rregull.

14. Kamion Kiper me kapacitet min 11t me kran me gjatësi min 20m,

kjo është pajisje me diskriminuese dhe skandalozë se bashku me gjeneratorët për ndriqim qfarë veqorie ka që kamioni të këtë peshën bartëse 11 ton dhe të këtë kran min 20 meter këto kërkesa të hartuara nga ju në këtë DT janë shumë skandalozë ku në tender 2.5 milion euro me qindra mijera kubik e dheut dhe zhavorit dhe keni bërë kërkesa për kamion me kran 20 meter dhe kamioneta me tonazh max 1 ton kërkojmë nga ana juaj si OSHP, pasi që AK nuk i ka larguar në kërkesën për rishqyrtim, të largohen këto kritere kufizuese kërkojmë që të hiqet nga aktiviteti për shkak se sipas analizës së parametres në këtë projekt nuk ka kurrfarë nevojë që të jete kamioni edhe kiper edhe me kran 20 meter.

18.Gjysmerimorkio kompresor për thyerje të pjeseve të forta min.1.5 ton – kjo pajisje është krejtësisht e kufizuar në tonazhën e saj pasi që thyerjet mund të bëhen edhe me kompresor më të vogël qfarë dallimi ka për 500 kg kompresori si 1 ton si 1.5 ku AK në këtë pozicion nëse ka dashur të kërkon kompresor me kapacitete më të mëdha ka qenë dashur të bëjë kërkesën me matës të ajrit BAR psh të këtë shtypje 40 ose 100 bar dhe jo me tonazh pasi kjo makineri nuk ka të bëjë asgjë me tonazh kërkojmë që të hiqet nga kriteri.

19.Gjysmerimorkio gjenerator maks.1 ton me kapacitet 600 m2 hapësirë ndriquese min 2 cope –

kjo pajisje është e panevojshme dhe diskriminuese sepse kjo pajisje hyn në punë vetëm në rastet kur punohet natën ashtu siç ka ndodhur të punoj në autostradë kompania Bechtel & Enka dhe vetëm atëherë nevojitet kjo pajisje kurse në rastin në fjalë askund në pozicione të parametres apo dosje të tenderit nuk çeket që do të punohet natën, kjo është krejtësisht diskriminuese për shkak të kërkesës specifike 600 m² dhe 12m lartësi kërkojmë nga ju si OSHP që të kërkonin sqarime edhe nga AK se kush ka qenë vendimtar që të kërkohej kjo pajisje kaq specifike me 12 m lartësi dhe si ka mundësi që një OE të argumenton se gjeneratori shpërndan ndriqim për 600 m² ku për këtë matje

kemi pyetur qendrat kompetente te licencuara ne Kosove sic jane QAK dhe kontrollet teknike te cilat kane thene se nuk kemi paisje adekuate per matje te nje vellimi te tille ky kriter eshte krejtesisht diskriminuose dhe eshte e panevojshme dhe si e tille duhet te hiqet nga kriteri .

20.Grejder min 20 ton (me repera dhe llaser digjital per nivelizim)

Grejderet me peshe me te vogel kryejn te njejtin funksion si dhe llaseri digjital eshte ipanevojshem te keto paisje pasi qe njejtin funksion kryhet nga finisher kur kerkohet saktesi me lart andaj keto kriterere jane shum selektive dhe favorizoj subjekete te caktuara andaj kerkojme te largohen si kriterere.

23. Kamionete kiper me peshe bartese deri 1 ton 2 cope-

kjo kamionet eshte krejtesisht e panevojshme dhe AK ka hartuar kriterere skandaloze dhe te pa nevojshme si ka mundesi kur flasim per nje projekt me vlerë 2.5 milion euro dhe me dhjetra mijera m3 kubik te zhavorit dheut e asfaltit ju si AK kerkoni kapacitet te kamionetave deri 1 ton peshe bartese ne vend se te kerkohen me shumë kamion me kapacitete me të mëdha, keto kapacitete sic i kerkoni ju ndikojn drejtperdrejt edhe ne vonesa te shumëta ne planin dinamik pasi me kamioneta kiper deri 1 ton nuk mund te largohen dhjetra mijera kubik zhavor germim te dheut etj ju si AK kerkoni kerkesa te tille nuk ka asnje nevoj te perdoret kjo kamionet per arsye se kapaciteti eshte i vogel dhe nuk kemi pjese apo rruge te ngushta qe duhet te punohet per tu perdorur kjo kamionet dhe eshte e panevojshme dhe se duhet te hiqet nga kriteri i DT-se.

Paisjet (13 deri ne 16) te kene libreza qarkullimi me validitet

Ky kriter teknikisht eshte i pamundeshem pasi qe nuk mund te kerkohet libreza per mjete te cilat barten me makineri percjellese ky kriter tregon joprofesionalizem dhe si i tille duhet te largohet dhe te jete ne kuader te kriterereve reale te cilat kane kuptim(si ka mundesi te kerkohet per eskavator dhe grejder libreze e regjistrimit ku ato paisje nuk lejohet ta shkelin rrugen ne kushte normale pos duke u bartuar me rimorkio te veqanta) veq nese ky kriter eshte vendos qe te favorizohet operator te caktuar ekonomik.

Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-31.5 mm t=28cm	m3	7140.00
--	----	---------

Tek pozicioni ne paramase furnizimi dhe punimi shtress me fraksion 0.31.5 mm keni parapare trashesin T=28cm kerkojme te rishikohet ky pozcicon dhe te behet ndryshimi i ketij pozicioni pasi 28 cm mendojme se eshte bere gabim teknik nga ana juaj sepse si ka mundesi zhavor 0.63 qe sherben si stabilizant te kete trashesi me te vogel se zhavori final 0.31.5 po ashtu edhe sasit e planifikuara nuk perputhen me trashesien.

- a. Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose
- b. Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE.

Kufizimi i konkurrencës ndikon që AK të demtoj buxhetin publik që bie ndesh me nenin 1 dhe 6 të LPP-se, andaj për tu ofruar mundësi të barabartë të gjithë OE-ve të ineteresua poashtu edhe kompanive të reja që të futen në treg të largohen këto kritere diskriminuese dhe ofertimi të jetë me fer apo me korrekt.

AK ka bërë shkeljen e paragrafit 10.2 të nenit 108 A të LPP-se sepse pasi që shihet haptaz që ka kritere diskriminuese në këto aktivitete thote shumë qarte se “AK me ane të një vendimi mund të miratojë një kërkesë për rishqyrtim si të bazuar dhe të anulojë vendimin e vet”

Në këto rast kërkojmë nga ju si OSHP që të merrni masa ndaj AK për korrigjim të kritereve konform dispozitave ligjore të bëjë korrigjimin e kritereve të Njoftimit për Kontratë dhe dosjes së tenderit siq e kemi përshkruar si më lartë, në të kundërtën, në do të detyrohemi të drejtohem organeve kompetente për zbatim të ligjit.

Andaj, në si OE ankues, duke u bazuar në provat e paraqitura si më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merret paraysh kjo ANKESE dhe, që të merr:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar Ankesa dhe kriteret e kerkuara të FDT-se dhe Njoftimit për kontratë të HIQEN kriteret e panevojshme dhe diskriminuese sic i kemi përshkruar si më lartë për arsye se AK tu jep mundësi ofertimi të gjithë OE të interesuar.

KORRIGJOHEN kriteret sipas natyrës së projektit që mos të bëhet shkelje duke përdorur pajisje të panevojshme.

KRITERET PËR VLERËSIM

--

		<p>a).Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr.04 L-042.për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 .Neni 65. b)Në dokument nga Administra Tatimore e vendit tuaj të themelimit,se ju nuk jeni me vonësë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit ose jeni në marrëveshje për shlyrjen e borgjeve, para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës. c)Një dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush Kërkesat e përshtatshmeris të jetë i lëshuar së paku deri në gjashtëmujorin e fundit para datës se publikimit të Njoftimit të Kontratës</p>	<p>a).Në deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar dhe vulosur nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit. b).Vërtetim nga Administra Tatimore (kopje). c).Vërtetim nga Gjykata Themelore Departamenti për Qështje Ekonomike (kopje). Dokumentet (nën b dhe c) duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues,para publikimit të dhënies së kontratës.Në rast të dështimit në dorzimit të dokumentave të nën B dhe nën C,tenderi i tyre do të refuzohet dhe do të konfiskohet sigurimi i tenderit. AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar të radhës.</p>
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	<p>Përshtatshmëria profesionale:</p> <p>Kërkesa 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional,komercial dhe apo Regjistrin e ndermarjeve në vendin e juaj të themelimit Kërkesa 2 OE duhet të jetë i regjistruar në TVSH ose të jetë deklarues i TVSH së</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>Dëshmia 1. Certifikata e regjistrimit të biznesit ARBK me informatat për biznesin (kopje). Evidenca 2 Çertifikata e TVSH së (Kopje)</p>
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	<p>Kapaciteti ekonomik dhe financiar:</p> <p>Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqëshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE, gjatë tri viteve e fundit financiare, është jo më pak se 500.000.00 euro</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>Dëshmia 2.Deklarate nga banka qe deshmone se OE ka mjete te gatshme ne xhironlogari ose qasje ne kredite pa kushtezuar, dokumenti te jete original I nenshkruar dhe vulosur nga institucioni banker. Ne raste konzorciumit te gjithë antaret e grupit duhet te deshmojne se kane keto mjete ne xhironlogari apo qasje ne kredi.</p>
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	<p>Kapaciteti teknik dhe profesional:</p> <p>Kërkesa 3. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i></p> <p>Dëshmia 3. Lista e projekteve të ngjashme e vërtetuar, për tri vitet e fundit nga OE, të</p>

	<p>përfunduar me sukses kontratat e ngjashme, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), në vlerë minimale prej 3,750,000.00 Euro. Në rast të konzerciumit lideri duhet të ketë min 60% të kërkesës.</p>	<p>dëshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e punëve dhe natyrën e tyre, apo procesverbal të pranimit përfundimtar të punëve (kopje). Në rast se Operatori Ekonomik prezanton kontrata dhe referenca me Operator Ekonomik privat atëherë Operatori Ekonomik duhet të prezanton situacionet së bashku me transaksionin bankar, që përputhen me të njëjtën kontratë</p>
	<p>Kërkesa 4. Staf i të punësuarve, minimum 20 puntorë. Menaxheri i projektit të jetë inxh. I diplomuar i ndertimtarisë- drejtimi konstruktiv(ose master) me minimum, 3 vite pervojë, të jetë I certifikuar për menaxhim të kantierit të ndertimit; një (1) inxh. dipl. hidroteknik (ose master); me minimum, 3 vite pervojë, të jetë I certifikuar për Lead Auditor për menaxhim të çështjes ISO 9001 2015; një (1) inxh. dipl. ingjeodezisë (ose master) I licensuar nga AKK; NJë (1) bachelor të ingjeodezisë të licensuar nga AKK. me minimum, 3 vite pervojë. Një bsc i ndertimtarisë Konstruktive, Një bsc në inxhinieri të ndertimit dhe infrastrukturës 3 vite pervojë. Një Master ose Msc. i komunikacionit me së paku 3 vite pervojë pune në realizimin e projekteve të ngjashme; një inxhinier ose master i Elektroteknikës me së paku 3 vite pervoje pune në realizimin e projekteve të ngjashme. Punëtor për siguri dhe mbrojtje në punë 5, dhe 5 punëtorë për mbrojtje nga zjarri të kenë dëshmi certifikatë.</p>	<p>Dëshmia 4. Lista e stafit të punësuarve, min. 20 punëtor të nënshkruar nga kompania, bashkëngjitur kontratat ose parakontratat. Kompania duhet të sjellë listën së paku 20 punëtorve të nënshkruar dhe vulosur. Menaxheri i projektit të jetë inxh. i ndertimtarisë- konstruktive. Diplomat Universitare, të noterizuar nga vetë mbajtësit e tyre së bashku me datën e publikimit të këtij tenderi për të gjithë inxhinierët si dhe prej datës së Diplomimit 3 vite pervoje, CV dhe Referenca pune, Vendimi për caktimin e Menaxherit të leshuar nga OE. Për punëtorët certifikatat e trajnimit kopje të noterizuara nga vetë mbajtësit e tyre së bashku me datën e publikimit të këtij tenderi.</p>
	<p>Kërkesa 5. OE të disponoj a. Certifikatë e ISO STANDARTEVE 9001-2015 b. Certifikatë e ISO STANDARTEVE 39001 2012 c. Certifikatë e ISO STANDARTEVE 14001-2015 d. Certifikatë e ISO STANDARTEVE 45001-2018</p>	<p>Dëshmia 5. Të ofrojnë dëshmi mbi certifikatat e kërkuara, sipas kërkesës, të jenë kopje të noterizuara dhe të jenë valide.</p>

	<p>e. Certificate e ISO STANDARTEVE BS PASS 99 2012</p> <p>Kërkesa 6. Paisjet Teknike</p> <p>1.Eskavator me kapacitet min 35t min 1 cope2.Eskavator me kapacitet min 25t min 3 cope 3. Eskavator me luge rrafshueselevizese ne te dyjaanet special per hapjen e kanaleve me kapacitet 1m3 min 26t 4. Eskavator me çekan 8-10t min 1 cope5. Eskavator me zingjirgome min 8t 6. Buldozer me kapacitet min 15 t min 1 cope 7. Skip ngarkues min 1 cope 8. Cilinder min 17t min 2 cope 9. Cilinder min 12t min 1 cope 10. Cilinder me dhembeza min 12t min 1 cope 11. Freze hidraulike qe vendoset ne eskavator per grryerjen e gurit min 2 copë 12. Ngarkues min 17t min 1 cope 13. Kamion kipper me kapacitet min 10m3 min 10 cope 14. Kamion Kiper me kapacitet min 11t me kran me gjatesi min 20m 15.Eskavator min 10t min 1 cope 16. Eskavatori me gome max 6t 17.Gjysem rimorkio kipper me peshebartese min 7t min 1 cope 18.Gjysemrimorkio kompresor per thyerje te pjeseve te forta min 1.5t min 1 cope 19.Gjysem rimoriko sinjalizuese me gjenerator max 1t me kapacitet 12m lartsi ose 600m2 ndriqim min 2cope 20. Rrafshues (greder) min 20 t (me raperadhe laser digjital per nivelizim) min 1 cope 21.Rrafshues (greder) min 15t min 1 cope 22.Automikser vetengarkues per prodhimin e betonit min 1 cope 23.Kamionet kipper me peshe bartese deri 1 ton min 2 cope 24. Kamioneta per puntore min 4 cope 25.Pikup per puntore min 2 cope 26. Cisterne (tanket) e ujit min 1 cope</p> <p>Kërkesa 7. a) Operatori</p>	<p>Deshmia 6. Lista e mjeteve te punes(eneshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik per mjetet qe nuk regjistrohen nga pika (1 der 12) te deshmohen me fatura te blerjes, kontratete blerjes ose deklarata unike doganore, per automjetet qe regjistrohen nga pika (13 deri 26) librezat e qarkullimit me validitet. Ne rast se OE nuk posedon paisje mbi pronesine duhet te ofroje marreveshjen per marrjen me qira te paisjeve. Marreveshja duhet te jete ne emerte ketij projekti me validet te kohezgjatjes te kesaj kontare e nenshkruar dhe e vulosur nga te dyjat palet dhe e noterizuar.</p> <p>Dëshmia 7. Per pikata), b), c) Licenca apo leja e</p>
--	--	---

		<p>Ekonomik duhet te këtë Gurëthyes të licencuar në pronësi apo marrëveshje për furnizim me zhavor. b.Operatori Ekonomik duhet te këtë baze per prodhimin e betonit të licencuar në pronësi apo marrëveshje për furnizim me beton;c. Operatori Ekonomi kduhet te këtë baze te asfaltit të licencuar në pronësi apo marrëveshje për furnizim me asfalt.</p>	<p>vlefshme e lëshuar nga autoritetet per kate se kopje , (marrveshjate jete e noterizuar dhe e vertetuar nga noteri ne orgjinal dhe per keteprojekt)</p>
		<p>Kërkesa 8.OE duhet të plotësoj pjesen e -V- të kontratës , Identifikimi Financiar, shkarkohet nga dosja e tenderit. Dëshmia 3.Pjesa e -V-e kontratës ,Identifikimi financiar,të plotësohet nënëshkruhet dhe vulozet OE dhe përfaqësuesi i bankes.</p>	<p>Kërkesa 7.OE duhet të plotësoj pjesen e -V- të kontratës , Identifikimi Financiar, shkarkohet nga dosja e tenderit. Dëshmia 3.Pjesa e -V-e kontratës ,Identifikimi financiar,të plotësohet nënëshkruhet dhe vulozet OE dhe përfaqësuesi i bankes.</p>

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

n/a

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - GËRLICA - COMPANY SH. P.K.

Sqarim hyrës:

Autoriteti Kontraktues KOMUNA SHTIME, ka zhvilluar Aktivitetin e Prokurimit me titull: “Ndertimi i unazes se madhe Petrove - Reqak - Belince, Shtime” me nr. të prokurimit: “617-24-960-5-1-1”,

- Publikimi i njoftimit paraprak është bërë me datë: 09.02.2024;
- Publikimi i njoftimit për kontratë është bërë me datë: 15.08.2024;
- Publikimi i formularëve standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara është bërë me datat: 20.08.2024 dhe 05.09.2024;
- Me datë: 03.09.2024, operatori ekonomik: OE “GËRLICA - COMPANY SH. P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim pranë KOMUNA SHTIME;
- AK - KOMUNA SHTIME, me datë: 05.09.2024, mori Vendim për Refuzimin e kërkesës të ri-shqyrtimit të: OE “GËRLICA - COMPANY SH. P.K.” - Prishtinë;
- Operatori ekonomik pas refuzimit të kërkesës për ri-shqyrtim nga AK, me datë: 13.09.2024, ka parashtruar Ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim Publik;
- Operatori ekonomik: “GËRLICA - COMPANY SH. P.K.” në Ankesën e parashtruar pranë Organit Shqyrtues për Prokurim Publik, i ka paraqitur pretendimet e tij;
- Eksperti Shqyrtues pas pranimit të lëndës për ekspertizë, i ka analizuar të gjitha pretendimet e OE Ankues, dhe i ka trajtuar me kujdes duke i'u referuar legjislacionit në fuqi.

Përgjigje në pretendimet ankimore:

Operatori ekonomik OE “GËRLICA - COMPANY SH. P.K.”- Prishtinë, pretendon që Autoriteti Kontraktues – KOMUNA SHTIME, ka vendosur kërkesa diskriminuese në njoftimin për kontratë/dosje të tenderit, me rastin e publikimit të procedurës së prokurimit “Ndertimi i unazes se madhe Petrove - Reqak - Belince, Shtime” me nr. të prokurimit: “617-24-960-5-1-1”.

Sipas OE ankues kriteret e kapacitetit teknik dhe profesional janë diskriminuese për shumë OE dhe favorizuese për një OE ekonomik, që bie në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së. OE - “GËRLICA - COMPANY SH. P.K.” pretendon se më këtë veprim AK - Komuna Shtime ka shkelur nenin 1, nenin 6, nenin 7 dhe nenin 69 të LPP-së si dhe nenin 4 dhe nenin 17.17 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Eksperti shqyrtues fillimisht sqaron se, vendosja e kriterëve të vlerësimit është kompetencë dhe përgjegjësi e plotë e Autoritetit Kontraktues siç përcaktohet nga Neni 52.4 i LPP, por nuk duhet të kenë në asnjë rast efektin e dhënies së një lirie të pakufizuar sipas zgjedhjes së autoritetit kontraktues.

Pretendimi ankimor 1:

Ne piken 9.1 & 9.2 te FDT-se te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, AK ka kërkuar kriteret

Kërkesa 4. Staf i të punësuarve, minimum 20 puntorë. Menaxheri i projektit të jetë inxh. I diplomuar i ndertimtarisë- drejtimi konstruktiv(ose master) me minimum, 3 vite pervojë, të jetë i certifikuar per menaxhimte kantierit te ndertimit; një (1) inxh.dipl.hidroteknik (ose master); me minimum, 3 vite pervojë, te jete i certifikuar per Lead Auditor per menaxhimte cilesise ISO 9001 2015; nje (1) inxh.dipl. igjeodezisë (ose master) I licensuar nga AKK; NJë (1) bachelor tëgjeodezisë të licensuar nga AKK. me minimum, 3 vite pervojë. Një bsc i ndertimtaris Konstruktiv ,Njebsc ne inxhinier i ndertimor edhe infrastructure 3 vite pervojë.Një Master ose Msc.i. komunikacionit me se paku 3 vite pervojë pune në realizimin e projekte vetë ngjashme; nje inxhinier ose master i Elektroteknikes me se paku 3 vitepervoje pune ne realizimin e projekteve te ngjashme.Punëtor për siguri dhe mbrojtje në punë 5, dhe 5 punëtorë për mbrojtje nga zjarri të kenë dëshmi certifikatën.

Dëshmia 4. Lista e stafit e të punësuarve, min. 20 punëtor të në nshkruar nga kompania, bashkangjitur kontratat ose parakontratat. Kompania duhet të sjellë listën se paku 20 puntorve te nënshkrur dhe vulosur. Menaxheri i projektit të jetë inxh. iNdertimtarisë–konstruktiv. Diplomat Universitare, të noterizuar nga vet mbajtesit e tyre sidhe pas dates se publikimit te ketij tender për të gjithë inxhinieret si dhe prej datës se Diplomimit 3 vite pervojë, CV dhe Referenca pune, Vendimi per caktimin e Menaxheri te leshuar nga OE. Për punëtor certifikatat e trajnimit kopje të noterizuara nga vetem bajtesit e tyre pas dates se publikimit te ketij tenderi.

Te kriteri i kërkuar si me lart AK ne kete kriter ka kërkuar qe Ing.i diplomuar i ndertimtarise – drejtimi konstruktiv (ose master) me minimum 3 vite pervoje, te jete i certifikuar per menaxhimin e kantierit.

ing.ndertimtarise – hidro ose MSc te jete i certifikuar si Lead Auditor per menaxhim te cilesise ISO 9001: 2015. Pra ky kriter eshte diskriminues dhe kerkojme qe te hiqen Certifikata e kerkuar Lead Auditor per menaxhim te cilesise ISO 9001:2015, pasi qe eshte e panevojshme dhe si e tille duhet te hiqet sepse me keto kërkesa po beni shkeljen e nenit 7 te LPP-se.

Te hiqen keto kriteret per stafin pasi qe jane te panevojshme dhe kjo ndikon ne kufizimin e konkurrences ne kundershtim me nenin 7 te LPP-se dhe demtimin e buxhetit publik sipas nenit 1 dhe 6 te LPP-se.

Përgjigje në pretendimin e I-rë ankimor:

AK ka kërkuar që "Menaxheri i projektit të jetë inxhinier i diplomuar i ndertimtarisë – drejtimi konstruktiv (ose master) me minimum 3 vite pervojë". **Eksperti Teknik konsideron se, brenda këtij kriteri janë dy kërkesa të ndryshme.** Përveç diplomës për këtë Inxhinier është kërkuar të jetë i certifikuar për menaxhimin e kantierit te ndertimit. **Qëllimi i njëjtë mund të arrihet nëse kualifikimet mund të arrihen nga dy persona dhe asesi mos të kufizohet i njëjti person.** Pra ti jepet mundësia OE-ve që këtë kriter të mund ta plotësoj një person apo dy persona të cilët kanë kualifikimet e kërkuara nga AK.

Gjithashtu te kërkesa: "Një (1) inxhinier i diplomuar i ndertimtarisë – drejtimi hidroteknik (ose master) me minimum 3 vite pervojë, të jetë i certifikuar për Lead Auditor për menaxhim të

cilësisë ISO 9001 2015”, Eksperti Teknik konsideron se, edhe brenda këtij kriteri janë dy kërkesa të ndryshme dhe se mund të arrihet qëllimi i njëjtë nëse i’u jepet mundësia OE-ve që këtë kriter të mund ta plotësojë një person apo dy persona që kanë këto kualifikime dhe kurrsesi mos te kufizohet një person. AK gjatë përgatitjes së DT-së në bashkëpunim me njësinë kërkuese, duhet ta ketë parasysh arritjen e rezultatit dhe konkurrencën. **Andaj pretendimi i OE ankues është i Bazuar.**

Pretendimi ankimor 2:

<p>Kerkesa 6. Paisjet Teknike 1.Eskavator me kapacitet min 35t min 1 cope 2.Eskavator me kapacitet min 25t min 3 cope 3. Eskavator me luge rrafshueselevizese ne te dyjaanet special per hapjen e kanaleve me kapacitet 1m3 min 26t 4. Eskavator me çekan 8-10t min 1 cope 5. Eskavator me zingjirgome min 8t 6. Buldozer me kapacitet min 15 t min 1 cope 7. Skip ngarkues min 1 cope 8. Cilinder min 17t min 2 cope 9. Cilinder min 12t min 1 cope 10. Cilinder me dhembeza min 12t min 1 cope 11. Frezhidraulikeqevendoset ne eskavator pergrryerjen e guritmin 2 copë 12. Ngarkues min 17t min 1 cope 13. Kamion kipper me kapacitet min 10m3 min 10 cope 14. Kamion Kiper me</p>	<p>Deshmia 6. Lista e mjeteve te punes(enenshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik per mjetet qe nuk regjistrohen nga pika (1 der 12) te deshmohen me fatura te blerjes, kontratete blerjes ose deklarata unike doganore, per automjetet qe regjistrohen nga pika (13 deri 26) librezat e qarkullimit me validitet. Ne rast se OE nuk posedon paisje mbi pronesine duhet te ofroje marreveshjen per marrjen me qira te paisjeve. Marreveshja duhet te jete ne emerte ketij projekti me validet te kohezgjatjes te kesaj kontare e nenshkruar dhe e vulosur nga te dyjat palet dhe e noterizuar.</p>
<p>kapacitet min 11t me kran me gjatesi min 20m 15. Eskavator min 10t min 1 cope 16. Eskavatori me gome max 6t 17.Gjysem rimorkio kipper me peshebartese min 7t min 1 cope 18. Gjysemrimorkiokompresor per thyerjetepjeseveteforta min 1.5t min 1 cope 19. Gjysemrimorikosinjalizuese me gjenerator max 1t me kapacitet 12m lartsiose 600m2 ndriqim min 2cope 20. Rrafshues (greder) min 20 t (me raperadhe laser digjital per nivelizim) min 1 cope 21. Rrafshues (greder) min 15t min 1 cope 22. Automikservetengarkues per prodhimin e betonit min 1 cope 23. Kamionet kipper me peshebartesederi 1 ton min 2 cope 24. Kamioneta per puntore min 4 cope 25 Pikup per puntore min 2 cope 26. Cisterne (tanket) e ujit min 1 cope</p>	

Poashtu edhe te makineria e kerkuar kerkojme qe te hiqen disa kriteret qe nuk nderlidhen me natyren e projektit:

3. Eskavator me luge rrafshuese levizese ne te dyja anet special per hapjen e kanaleve me kapacitet 1m3 min 26t

kjo pajisje eshte diskriminuese sepse asnje OE nuk mund ta deshmoj me ndonje dokument kapacitetin m3 kubikazhen, e luges pasi ne kosove nuk ka institucion apo qender te licencuar per matje te nje gje te tille po ashtu edhe kufizimi tonazhes 26 ton kerkojme qe te jete dhe m i vogel sepse kjo pune mund t kryhet edhe me eskavator psh 22=24 ton etj.

Përgjigje në pretendimin e 2-të ankimor:

Lidhur me pretendimin e lartcekur, **Eksperti teknik konsideron se, kërkesa "Eskavator me luge rrafshuese levizese ne te dyja anet special per hapjen e kanaleve me kapacitet 1m3 min 26t" kufizon konkurrencën në mes të OE duke e specifikuar llojin e funksionimit, kapacitetin e saj dhe tonazhen e makinerisë.** Duke pas sparasysh puna që do të kryhet, e njëjta punë mund të realizohen me makineri të tonazhave me të vogla dhe me kova (lugë) më të vogla apo më të mëdha andaj eksperti teknik rekomandon AK-në që gjatë Korigjimit të DT këtë kriter ta zëvendësojë me:

- Ekskavator me lugë rrafshuese lëvizëse ne te dyja anët special për hapjen e kanaleve me kapacitet min 15t.

Andaj pretendimi i OE ankues është i Bazuar.

Pretendimi ankimor 3:

11. Freze hidraulike qe vendoset ne eskavator per grryerjen e gurit min 2 copë duke u bazuar ne paramase nuk ka kategori te gurit per tu frezuar me frez hidraulike nje gje e tille nuk eshte parapare fare , po ashtu vet nga ju ne kete pozicion e keni cekur se do te behet thyrja me eskavator me cekan pikerisht qe e keni pershkruar ne paramase e keni kerkuar qe me eskavator te behet thyerja dhe per kete pozicion ne kritere e keni kerkuar eskavatorin 8=10 ton me cekan per te cilen mendojme se eshte ne rregull.

Përgjigje në pretendimin e 3-të ankimor:

Eksperti Teknik konsideron se, pajisja e kërkuar në nr. rendor 11, tek kërkesa nr. 6 pajisjet teknike, "Freze hidraulike qe vendoset ne eskavator per grryerjen e gurit min 2 copë", nuk është relevante dhe drejtpërdrejt e lidhur me objektin e kontratës. AK nuk ka specifikuar se puna do të kryhet në këtë formë, dhe rekomandon që AK gjatë Korigjimit të DT ta heqë këtë kërkesë. **Andaj pretendimi i OE ankues është i Bazuar.**

Pretendimi ankimor 4:

14. Kamion Kiper me kapacitet min 11t me kran me gjatesi min 20m, kjo eshte pajisje me diskriminuese dhe skandaloze se bashku me gjeneratoret per ndriqim qfare veqorie ka qe kamioni te kete peshen bartese 11 ton dhe te kete kran min 20 meter keto kerkesa te hartuara nga ju ne kete DT jane shume skandaloze ku ne tender 2.5 milion euro me qindra mijera kubik e dheut dhe zhavorit dhe keni bere kerkesa per kamion me kran 20 meter dhe kamioneta me tonazh max 1 ton kerkojm nga ana juaj si OSHP, pasi qe AK nuk I ka larguar ne kerkesen per rishqyrtim, te largohen keto krite kufizuese kerkojme qe te hiqet nga aktiviteti per shkak se sipas analizes se paramases ne kete projekt nuk ka kurrfar nevojte qe te jete kamioni edhe kiper edhe me kran 20 meter.

Përgjigje në pretendimin e 4-të ankimor:

Eksperti Teknik konsideron se, pajisja e kërkuar në nr. rendor 14, tek kërkesa nr. 6 pajisjet teknike "Kamion Kiper me kapacitet min 11t me kran me gjatesi min 20m", kufizon konkurrencën në mes të OE duke specifikuar llojin e funksionimit, kapacitetin e saj dhe tonazhen e makinerisë dhe e njëjta makineri ti kryejë dy funksione.

Eksperti teknik po ashtu konsideron se, kjo kërkesë nuk është relevante dhe drejtpërdrejt e lidhur me objektin e kontratës në këtë specifikim andaj rekomandon AK-në që gjatë Korrigjimit të DT ta heqë këtë kërkesë dhe nëse është nevoja ta zëvendësoj me:

- Kamion kipper me kapacitet minimum 10t , dhe

- kamion me kran 10t , gjatësia e kranit min 10m (pozicion ku hyn në punë kjo makineri janë lëshesat dhe mund të montohen me këtë kapacitet të makinerisë pa problem dhe te shkarkimi i armaturave për realizimin e murit mbrojtës).

Andaj pretendimi i OE ankues është i Bazuar.

Pretendimi ankimor 5:

18.Gjysmerimorkio kompresor per thyerje te pjeseve te forta min.1.5 ton – kjo pajisje eshte krejtesishte e kufizuar ne tonazhen e saj pasi qe thyerjet mund te behen edhe me kompresor me te vogel qfar dallimi ka per 500 kg kompresori si 1 ton si 1.5 ku AK ne kete pozicion nese ka dashur te kerkon kompresor me kapacitete me te medha ka qene dasht te ben kerkesen me mates te ajrit BAR psh te kete shtypje 40 ose 100 bar dhe jo me tonazh pasi kjo makineri nuk ka te beje asgje me tonazh kerkojme qe te hiqet nga kriteri.

Përgjigje në pretendimin e 5-të ankimor:

Sa i përket kërkesës së lartcekur "Gjysem rimorkio kompresor per thyerje te pjeseve te forta min 1.5t min 1 cope", **Eksperti teknik konsideron se, kërkesa kufizon konkurrencën në mes të OE dhe nuk është e specifikuar saktë.** Kapaciteti i kompresorave nuk matet me peshën që kanë por me fuqinë e tyre, andaj rekomandohet AK që gjatë Korrigjimit të DT ta specifikoj mire kërkesën në bazë të fuqisë dhe gjithnjë në bazë të nevojave të projektit. **Andaj pretendimi i OE ankues është i Bazuar.**

Pretendimi ankimor 6:

19.Gjysmerimorkio gjenerator maks.1 ton me kapacitet 600 m2 hapësire ndriqese min 2 cope -

kjo pajisje është e panevojshme dhe diskriminuese sepse kjo pajisje hyn në punë vetëm në rastet kur punohet natën ashtu siq ka ndodhur të punoj në autostradë kompania Bechtel & Enka dhe vetëm atëherë nevojitet kjo pajisje kurse në rastin në fjalë askund në pozicione të paramases apo dosje të tenderit nuk ceket që do të punohet natën, kjo është krejtësisht diskriminuese për shkak të kërkesës specifike 600 m2 dhe 12m lartësi kërkojmë nga ju si OSHP që të kerkoni sqarime edhe nga AK se kush ka qenë vendimtar që të kerkohet kjo pajisje saqë specifike me 12 m lartësi dhe si ka mundësi që një OE të argumenton se gjeneratori shpërndan ndriqim për 600 m2 ku për këtë matje

kemi pyetur qendrat kompetente të licencuara në Kosovë sic janë QAK dhe kontrollat teknike të cilat kanë thënë se nuk kemi pajisje adekuate për matje të një vëllimi të tillë ky kriter është krejtësisht diskriminues dhe është e panevojshme dhe si e tillë duhet të hiqet nga kriteri .

Përgjigje në pretendimin e 6-të ankimor:

Sa i përket pretendimit të lartcekur, **Eksperti Teknik konsideron se, pajisja e kërkuar nr. 19 “Gjysmë rimorkio sinjalizuese me gjenerator max 1t me kapacitet 12m lartësi ose 600m2 ndriqim min 2cope”, kufizon konkurrencën në mes të OE-ve, duke e specifikuar llojin e funksionimit, kapacitetin e saj dhe tonazhën e pajisjes.** Eksperti teknik po ashtu konsideron se, kjo kërkesë nuk është relevante dhe drejtpërdrejt e lidhur me objektin e kontratës më këtë specifikim. Në dosje të tenderit nuk parashihet që punët të kryhen natën, nuk ka objekte të larta për të kërkuar një lartësi të tillë të trupës ndriçuese, pra nuk është specifikuar nga AK-ja pse është kërkuar kjo pajisje.

Rekomandohet AK që gjatë Korrigjimit të DT ta heqë këtë kërkesë ose ta zëvendësojë me:

- Gjysmë rimorkio sinjalizuese me gjenerator (duke e specifikuar për çfarë arsye të përdoret në lidhje me objektin e kontratës në fjalë).

Andaj pretendimi i OE ankues është i Bazuar.

Pretendimi ankimor 7:

20.Grejder min 20 ton (me repera dhe llaser digjital për nivelizim)

Grejderet me peshe me të vogël kryejnë të njëjtin funksion si dhe llaseri digjital është i panevojshëm të këto pajisje pasi që të njëjtin funksion kryhet nga finisher kur kerkohet saktësi me lartësi andaj këto kriterë janë shumë selektive dhe favorizojnë subjektet e caktuara andaj kërkojmë të largohen si kriterë.

Përgjigje në pretendimin e 7-të ankimor:

Lidhur me pretendimin e lartcekur, **Eksperti Teknik sqaron se, pajisja e kërkuar “Rrafshues (greder) min 20 t (me repera dhe laser digjital për nivelizim) min 1 cope” kufizon konkurrencën në mes të OE** duke e specifikuar llojin e funksionimit, kapacitetin e saj dhe tonazhën e pajisjes.

Sipas Ekspertit teknik, këto pajisje në tregun tonë janë të rralla dhe funksionin e njëjtë mund të kryhet edhe me pajisje tjera të pa digjitalizuara, andaj rekomandohet AK që gjatë Korrigjimit të DT ta heqë këtë kërkesë dhe nëse është nevoja ta zëvendësoj me:

- Rrafshues (greder) min 20 t.

Andaj pretendimi i OE ankues është i Bazuar.

Pretendimi ankimor 8:

23. Kamionete kiper me peshe bartese deri 1 ton 2 cope-

kjo kamionet eshte krejtesisht e panevojshme dhe AK ka hartuar kriteret skandaloze dhe te pa nevojshme si ka mundesi kur flasim per nje projekt me vlerë 2.5 milion euro dhe me dhjetra mijera m3 kubik te zhavorit dheut e asfaltit ju si AK kerkoni kapacitet te kamionetave deri 1 ton peshe bartese ne vend se te kerkohen me shumë kamion me kapacitete me të mëdha, keto kapacitete sic i kerkoni ju ndikojn drejtperdrejt edhe ne vonesa te shumëta ne planin dinamik pasi me kamioneta kiper deri 1 ton nuk mund te largohen dhjetra mijera kubik zhavor germim te dheut etj ju si AK kerkoni kërkesa te tille nuk ka asnje nevoj te perdoret kjo kamionet per arsye se kapaciteti eshte i vogel dhe nuk kemi pjese apo rruge te ngushta qe duhet te punohet per tu perdorur kjo kamionet dhe eshte e panevojshme dhe se duhet te hiqet nga kriteri i DT-se.

Përgjigje në pretendimin e 8-të ankimor:

Eksperti Teknik konsideron se, AK me kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional “Kamionet kiper me peshe bartëse deri 1 ton min 2 cope”, ka kufizuar konkurrencën në mes të OE duke e specifikuar llojin e funksionimit, kapacitetin e saj dhe tonazhen e pajisjes. Ekspertiteknik konsideron se, kërkesa nuk është relevante dhe drejtpërdrejt e lidhur me objektin e kontratës më këtë specifikim, nuk është specifikuar pse i kanë kërkuar këtë pajisje, andaj rekomandon AK-në që gjatë Korrigjimit të DT ta heqë këtë kërkesë apo ta zëvendësoj me:

- Kamioneta kiper apo kamion kiper me peshë bartëse deri 3.5t.

Andaj pretendimi i OE ankues është i Bazuar.

Pretendimi ankimor 9:

Paisjet (13 deri ne 16) te kene libreza qarkullimi me validitet

Ky kriter teknikisht eshte i pamundeshem pasi qe nuk mund te kerkohet libreza per mjete te cilat barten me makineri percjellese ky kriter tregon joprofesionalizem dhe si i tille duhet te largohet dhe te jete ne kuader te kriterëve reale te cilat kane kuptim (si ka mundesi te kerkohet per eskavator dhe grejder libreze e regjistrimit ku ato paisje nuk lejohet ta shkelin rrugen ne kushte normale pos duke u bartuar me rimorkio te veqanta) veq nese ky kriter eshte vendos qe te favorizohet operator te caktuar ekonomik.

Përgjigje në pretendimin e 9-të ankimor:

Lidhur me pretendimin e lartcekur, **Eksperti teknik sqaron** si në vijim:

Duke ju referuar dosjes së tenderit të kërkesa nr .6 Paisjet Teknike, dëshmia e kërkuar:

Dëshmia 6. Lista e mjeteve të punës (enenshkruar dhe e vulosur), operatori ekonomik për mjetet që nuk regjistrohen nga pika (1 der 12) të dëshmohen me fatura të blerjes, kontratat e blerjes ose deklarata unike doganore, për automjetet që regjistrohen nga pika (13 deri 26) librezat e qarkullimit me validitet. Në rast se OE nuk posedon paisje mbi pronesinë duhet të ofrojë marrëveshjen për marrjen me qira të paisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohezgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe e vulosur nga të dyjat palet dhe e noterizuar.

AK ne DT nuk e ka specifikuar qartë se cilat pajisje duhet të kenë fatura shitblerjes/kontratat e blerjes/Deklaratat unike doganore e cilat duhet të kenë librezat të qarkullimit me validitet (sepse paisjet/makinerit e të dyja grupeve (1-12) dhe (13-26), pra në të dy grupet ka pasigje që mund të kenë edhe librezat valide por edhe të transportohen e që mund të dëshmohen me dëshmi tjera) andaj rekomandoi AK që gjatë Korrigjimit të DT të shtoj: - Paisjet/Makinerit të cilat nuk regjistrohen duhet të dëshmohen me: Fatura të shitblerjes ose/apo marrëveshjes të shitblerjes ose/apo DUD-a (DOKUNET UNIK DOGANOR).

Ndërsa,

-Paisjet/Makinerit të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezat e qarkullimit me validitet.

Andaj pretendimi i OE ankues është pjesërisht i Bazuar, pasi që Dëshmitë e kërkuara nga AK nuk janë të specifikuar qartë dhe duhet të korrigjohen.

Pretendimi ankimor 10:

Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-31.5 mm t=28cm	m3	7140.00
--	----	---------

Tek pozicioni në paramasë furnizimi dhe punimi shtresë me fraksion 0.31.5 mm keni parapare trashesin T=28cm kërkojmë të rishikohet ky pozicion dhe të bëhet ndryshimi i këtij pozicioni pasi 28 cm mendojmë se është bërë gabim teknik nga ana juaj sepse si ka mundësi zhavor 0.63 që shërben si stabilizant të kësaj trashësie me të vogël se zhavori final 0.31.5 po ashtu edhe sasitë e planifikuara nuk përputhen me trashesinë.

Përgjigje në pretendimin e 10-të ankimor:

Sa i përket pretendimit ankimor të lartcekur, **Eksperti Teknik sqaron se, sipas të dhënave dhe shpjegimeve të pretendimit nga OE ankues dhe dokumenteve në platformën e-prokurimit një shpjegim duhet të jepet nga vet AK-ja. Eksperti teknik rekomandon se, Autoriteti kontraktues gjatë Korrigjimit të DT, në konsultim me Njësinë kërkuuese apo e hartuesin e projektit (specifikimeve teknike), duhet të sqaroj saktë se, si ka paraparë realizimin e këtij**

pozicioni duke e dëshmuar edhe me skica dhe të njëjtat ti ngarkoj në platformën e-prokurimit për të gjitha palët e interesuara. **Andaj pretendimi i OE ankues është pjesërisht i Bazuar, pasi që në platformën e e-prokurimit nuk ka skica, apo detaje për ta vërtetuar këtë pretendim, mbetet AK-ja të japë sqarim.**

Eksperti shqyrtues propozon që, AK të veprojë konform nenit 53.7 të LPP-së, të bëjë përmirësimet e dosjes së tenderit dhe të shtyjë afatin për ofertim, e po ashtu ti rivendos kërkesat konform paragrafit 3 të nenit 51 të LPP-së: *"Të gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse".*

AK duhet të ketë parasysh se kërkesat e panevojshme, përpos që janë vështirë të arritshme, krijojnë edhe shpenzime materiale të panevojshme për OE ku të njëjtat, më pas do të jenë kosto për AK pasi që OE ato do të i kalkulojnë të gjitha në çmimin e tenderit.

Eksperti shqyrtues i'a rikujton AK - KOMUNA SHTIME se, në pajtim me LPP-në, Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik si dhe Udhëzuesin Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik kriteret e vlerësimit duhet të përcaktohen nga Autoritetet Kontraktuese, në mënyrë që të garantojnë respektimin e parimeve të transparencës, mos-diskriminimit dhe trajtimit të barabartë. Për më tepër, duhet të sigurojnë një nivel të përshtatshëm konkurrence.

Po ashtu gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim në pajtim me nenin 8.4 të Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurimin Publik: *"AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike. "Të arsyeshme dhe të mjaftueshme" do të nënkuptoj në lidhje me: i. vlerën e parashikuar të kontratës, dhe ii. përdorim të drejtë të fondeve publike".*

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues dhe eksperti teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “GËRLICA - COMPANY SH. P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i unazës së madhe Petrovë - Reçak - Belincë, Shtime” me numër të prokurimit: “617-24-960-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA SHTIME

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA SHTIME**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **GËRLICA - COMPANY SH. P.K.**



Valmirë Deliu

Mentor Gallapeni